V E N D I M
Nr.218, datë 4.4.1998

PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN E KËSHILLIT TË MINISTRAVE NR.518, DATË 12.8.1996 "PËR KATEGORIZIMIN, KLASIFIKIMIN DHE REGJISTRIMIN E NJËSIVE AKOMODUESE"

Me propozimin e Ministrisë së Tregtisë dhe Turizmit, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Në vendimin e Këshillit të Ministrave nr.518, datë 12.8.1996, pika 5 ndryshon si vijon:

"Të krijohet regjistri i njësive akomoduese në Ministrinë e Tregtisë dhe Turizmit. Çdo njësi akomoduese është e detyruar t'i nënshtrohet regjistrimit si në rastin kur përfshihet në guidën e klasifikimit të njësive akomoduese, ashtu edhe kur e ushtron këtë veprimtari akomuduese jashtë këtij kategorizimi e klasifikimi.

Regjistrimi i subjekteve që ushtrojnë veprimtari akomoduese në regjistrin e njësive akomoduese, do të bëhet pasi të paraqitet prej tyre vendimi i gjykatës për regjistrimin e tyre si person juridik me objekt ushtrimin e veprimtarisë akomoduese.

Subjektet juridike që ushtrojnë veprimtari akomoduese, për të bërë regjistrimin në zyrat e tatimeve, duhet të paraqesin, përveç dokumenteve të tjera, edhe certifikatën e regjistrimit dhe klasifikimit të lëshuar nga Ministria e Tregtisë dhe Turizmit".

2. Në të gjitha pikat e vendimit fjalët "Ministria e Punëve Publike, Rregullimit të Territorit dhe Turizmit" dhe "Sekretari i Shtetit për Turizmin" ndryshohen dhe zëvendësohen përkatësisht me fjalët "Ministria e Tregtisë dhe Turizmit" dhe "Ministri i Tregtisë dhe Turizmit".

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Fatos Nano